

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATINGJ.S.C.GJAKOVA

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: +381 (0) 390 328-329

Nr. i Biznesit: 811326471
www.ngrohtorja.org

Më 18.10.2022
Nr.598

<i>Për:</i>	Komisionin e Aksionarit të KK - Gjakovë
<i>Nga:</i>	N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë-Bordi i Drejtorëve
<i>Lenda:</i>	Raporti i punës për N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë për vitin 2021

Raporti i Bordit të Drejtorëve – “Ngrohtorja e Qytetit” Sh.A. Gjakovë



Përmbajtje

1.1.	Kushtet e referencës	3
1.2.	Përmbledhje e raportit.....	3
1.3.	Kronologjia e proceseve dhe aktiviteteve për vitin 2021 NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë SH.A.	4
1.4.	Raportimi nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv	5
Historiku		6
Informatat e përgjithshme		6
1.5.	Spektori i Financave dhe Thesarit	12
1.6.	Spektori i faturimit dhe inkasimit.....	17
1.7.	Spektori i prokurimit.....	20
1.8.	Spektori Juridik/Administrativ.....	21
1.9.	Burimet njerëzore	22
1.10.	Spektori Operativ	22
1.11.	Rekomandime	24

1.1. Kushtet e referencës

Ky raport pasqyron gjendjen reale të kompanisë NP “Ngrohtorja e qytetit” Gjakovë Sh.A.

Qëllimi në përmbajtje të raportit është informimi i Komisionit të Aksionarëve të NP “Ngrohtorja e Qytetit” Gjakova Sh.A., në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2021.

1.2. Përmbledhje e raportit

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihet një historik i shkurtër i ndërmarrjes, i pasuar me aktivitetet dhe ngjarjet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2021. Ky raport është punuar bazuar në kërkesat ligjore dhe udhëzimit administrative. Gjithashtu përmban edhe informacione tjera, të cilat e bëjnë këtë raport më gjithëpërfshirës për të pasqyruar në mënyrë të qartë punën e ndërmarrjes për periudhën raportuese.

Në fillim të raportit e gjeni Historikun e shkurtër të ndërmarrjes, për të krijuar përshtypjen e përgjithshme për pritshmërinë dhe për të kuptuar më qartë natyrën e punës. Kjo pjesë e raportit ofron të dhëna historike qysh nga themelimi i ndërmarrjes e deri më sot.

Pas historikut do të renditen aktivitetet e bordit të drejtoreve. Pasojnë raportet të cilat përfshijnë aktivitetet e ndërmarrjes duke filluar nga pjesa e prodhimit të energjisë termike, duke vazhduar me aktivitetet në njësinë e shpërndarjes, aktivitetet e prokurimit, aktivitetet e shërbimit juridik, aktivitetet e auditorit të brendshëm, aktivitetet e shërbimit financiar, shërbimit për konsumatorë. Sfidat dhe Rreziqet janë pjesë e këtij raporti. Gjithashtu brenda raportit janë përfshirë edhe aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Me qëllim që raporti të jetë sa më i qartë dhe lehtë i kuptueshëm, në të janë inkuadruar edhe tabela si dhe grafikone.

1.3. Kronologjia e proceseve dhe aktiviteteve për vitin 2021 NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë SH.A.

Bordi i drejtoreve i Ngrohtores së Qytetit Sh.A. Gjakovë ka mbajtur takime të rregullta në bazat mujore dhe takim të jashtëzakonshme sipas nevojës ku në secilën mbledhje janë trajtuar pikat e zakonshme si Kurumi, aprovimi i pikave të rendit të ditës dhe procesverbalit paraprak shqyrtimi dhe miratimi i raportit Komisionit të Auditimit dhe Raportit të KE-së.

Gjatë vitit 2021 janë mbajtur 7 mbledhje të BD-ve, janë shqyrtuar dhe aprovuar këto vendime:

- Vendimi për trajnimet e stafit sipas kërkesës së udhëheqësit të prodhimit për 10 punonjësit e departamentin të prodhimit me dt. 04.02.2021
- Vendimi për ndryshimin në statut të ndërmarrjes sipas kërkesës së sekretares , sipas kërkesës ligjore për ndryshimin sa i përket shtimit sekondar për prodhim të energjisë elektrike me dt.04.02.2021.
- Aprovimet e raporteve të KE-së, ZKF-së dhe Sekretares për tremujorin e fundit të 2020 dhe raportet vjetore për 2020 me dt. 19.03.2021.
- Aprovimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2020 me dt. 19.03.2021.
- Aprovimet e raporteve të KE-së, ZKF-së dhe Sekretares për tremujorin e parë të 2021 me dt. 28.05.2021.
- Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të auditorit të jashtëm me dt.28.05.2021.
- Aprovimi i raportit për Komisionin Komunal të Aksionarit për vitin 2020 me dt.02.07.2021.
- Aprovimet e raporteve të KE-së, ZKF-së dhe Sekretares për tremujorin e dytë të 2021 me dt. 19.09.2021.
- Vendimi për fillimin e sezonës ngrohëse 2021/2022 me dt. 19.09.2021.
- Vendimi që të dërgohet kërkesa në ZRRE për mos shqyrtim tarifar me dt. 19.09.2021.
- Vendimi për aprovimin e planit 3 vjeçar dhe 5 vjeçar me dt. 03.10.2021
- Aprovimi i planit të biznesit me dt. 29.10.2021.

1.4. Raportimi nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

Sikurse edhe viteve paraprake, ndërmarrja ka vazhduar të përballet me vështirësi financiare por kësaj radhë për shkak të vonesave në fillimin e funksionimit të impiantit të ri, të cilat kanë ndikuar në të gjitha drejtimet e saj. Përkrahja e ofruar tash e sa vite me radhë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila përmes subvencioneve të rregullta ka vazhduar të mbulojë shpenzimet e lëndës djegëse, ka mundësuar vazhdimin e operimit dhe ofrimin e shërbimeve për konsumatorët tanë me një kosto të ulët, e cila tash e sa vite ka ngelur e njëjtë.

Ky është sezoni i parë që ndërmarrja operon me impiantin e ri me biomasë pas testimeve dhe periudhës provuese e cila është kryer periodikisht në periudhën Janar - Qershor 2021.

Pas kërkesës që është bërë nga ana e ndërmarrjes që mos të kemi shqyrtim tarifor, kemi marrë përgjigjen nga ZRRE se aplikimi për tarifa duhet të bëhet gjithsesi. Ky vendim i ZRRE-së për aplikim tarifor e komplikon edhe më tej situatën e ndërmarrjes pasi që një proces i tillë nuk është lehtë e aq më tepër me rrethanat ekzistuese kur çdo gjë është një ngjarje e re e cila presim të na japë informacion për të planifikuar për të ardhmen.

Një gjë shumë pozitive e cila është evidente gjatë viteve të fundit, e rrjedhimisht edhe në vitin 2021, është shkalla e inkasimeve e cila vazhdon të mbetet në nivel të lartë. Kjo çështje e cila për shumë ndërmarrje publike në Kosovë, ndonëse deri para 6 viteve edhe për Ngrohtoren e Qytetit në Gjakovë ka qenë pengesë evidente në afarizmin e ndërmarrjes, tashmë është stabilizuar pothuajse tërësisht.

Testimet e kaldajave termike të Ngrohtores së Re janë bërë me 16.01.21 dhe kanë vazhduar deri me datën 18.02.2021 dhe kanë arritur të testohen të dy kaldajat termike. Kaldaja e kombinuar është testuar në periudhën Maj – Qershor 2021. Ndonëse ishte planifikuar që me datën 30.06.2021 të bëhet pranim dorëzimi i objektit, për shkak të disa gjërave të vogla të papërfunduara dhe kompletimit të dokumentacionit, kjo datë është shtyrë deri në plotësimin e këtyre kushteve. Dhe pranim dorëzimi preliminar i impiantit është bërë me 07.07.2021.

Po vazhdojnë punimet e projektit "Përmirësimin e performancës së Ngrohtores së Qytetit në Gjakovë" – financuar nga SECO Zvicerane dhe KK Gjakovë. Në vlerën e përgjithshme të këtij projekti, SECO merr pjesë me 5.3 milionë €, ndërsa 0.5 milionë nga Komuna e Gjakovës. Përfitues të këtij projekti është Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë dhe Spitali Rajonal i Gjakovës.

Ky projekt përbëhet nga 4 komponentë:

1. Zhvillimi i Korporatës

2. Përmirësimi i eficiencën së energjisë në rrjetin e NQ
3. Avancimi i rrjetit të ngrohjes së Spitalit
4. Lidhja e ndërtesave tjera publike.

Po ashtu kemi nënshkruar një memorandum mirëkuptimi në mes të AKP-së, KK dhe Ngrohtores së Qytetit për pastrimin e 500 ha pyje te Pashtriku e dt. 22.09.2021, të cilët kanë filluar punën dhe janë duke vazhduar. Ky projekt financohet nga GIZ dhe ka për qëllim zbutjen e papunësisë. Përmes këtij projekti Ngrohtorja do të ketë informacion të saktë rreth potencialit të mbetjeve pyjore të cilat do të mund të shfrytëzohen për përfitimin e biomasës. Vlera e projektit kap vlerën rreth 160.000 Euro.

Historiku

Ndërmarrja Publike "Ngrohtorja e Qytetit" në Gjakovë është themeluar në vitin 1981 dhe nga Janari i vitit 2008 është shndërruar në shoqëri aksionare. Me miratimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nga Kuvendi i Kosovës në qershor të 2008 pronare e plotë e kësaj ndërmarrje është Komuna e Gjakovës me 100% të aksioneve.

Ndërmarrja ofron shërbimet e ngrohjes duke operuar në sektorin publik, komercial dhe atë të amvisërisë në territorin e qytetit të Gjakovës. Ndërmarrja funksionon në bazë të ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, akteve tjera normative dhe standardeve të kontabilitetit.

Informatat e përgjithshme

Ndërmarrja Publike Lokale "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. në Gjakovë është Shoqëri Aksionare, me numër të regjistrimit të biznesit: 811326471, me adresë në Gjakovë, rruga "Tirana", PN. Organizimi i ndërmarrjes është i strukturuar ku sipas hierarkisë përfshihen Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv kurse në kuadër të strukturës së brendshme janë gjithsej katër shërbime:

- Shërbimi Financiar,
- Shërbimi i Prodhimit
- Shërbimi i Shpërndarjes dhe Furnizimit
- Shërbimi A




Figura 1. Organogrami i Ndërmarrjes

Veprimtaria e ndërmarrjes e licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) përfshinë:

- Prodhimin e energjisë termike,
- Shpërndarjen e energjisë termike dhe
- Furnizimin e konsumatorëve me energji termike
- Prodhimi i energjisë elektrike;

Prodhimi i energjisë termike bëhet me kapacitetet e reja për prodhimin e energjisë termike (ngrohjes) dhe bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe termike do të mundësojnë prodhim të mjaftueshëm për një furnizim cilësor të konsumatorëve.

Kapacitetet prodhuese aktuale me impiantin e ri janë:

- Njësitë (kaldataj) për prodhim të energjisë termike me kapacitet nominal 2 x 5.5MWTH;
- Njësia e ko-gjenerimit të energjisë elektrike dhe asaj termike me kapacitetet 1.2MWEL dhe 4WTH;

Pra gjithsejtë kapacitetit i prodhimit të ngrohjes (energjisë termike) 15 MWTH dhe Kapaciteti e prodhimit të energjisë elektrike 1.2 MWEL

Shpërndarja e energjisë termike bëhet përmes rrjetit të termofikimit i cili përfshin të ashtuquajturin rrjetin primar dhe shtrihet në dy pjesë duke u nisur nga njësia e prodhimit të energjisë termike.

Pjesa e vjetër e rrjetit e cila shtrihet nga Ngrohtorja e Qytetit, shkon në drejtim të pjesës veriore të Qytetit dhe arrin deri te shkolla fillore Zekeria Rexha. Në këtë pjesë të rrjetit të vendosur në vitin 1980, janë të kyçur kryesisht Institucione, si: Shkolla, shtëpi të shëndetit, Kuvendi Komunal, Pallati i Kulturës si dhe ndërtesa kolektive. Kjo pjesë e rrjetit përbën një gjatësi të trasesë prej 5.6 km e cila i përfshin dy gypa te ujit. Këta gypa janë gypa të zi të izoluar me lesh mineral dhe i mbështjellur me ter letër të vendosur në kanal të betonit.

Pjesa e re e rrjetit, e vendosur nga Ngrohtorja e Qytetit, shkon në drejtim të pjesës jugore të Qytetit duke arritur deri te Spitali rajonal Isa Grezda, i cili gjithashtu furnizohet me ngrohje. Kjo pjesë e rrjetit ka qenë donacion i SIDA-s organizatë Suedeze e vendosur në vitin 2001 dhe qëllimi kryesorë ka qenë të mundësoje kyçjen e Spitalit në rrjetin primar të termofikimit. Pjesa jugore e rrjetit përfshin një gjatësi prej 16.6 km trase në të cilën janë të vendosur dy gypa të paraizoluar. Në këtë pjesë të rrjetit kemi një kombinim pak më ndryshe të konsumatorëve të kyçur në rrjet, krahasuar me pjesën veriore të rrjetit. Karakteristikë e kësaj pjese të rrjetit është se përveç institucioneve dhe disa ndërtesave kolektive, strukturën e konsumatorëve sipas numrit të tyre e dominojnë shtëpitë individuale, të cilat edhe sot përbëjnë një pjesë shumë të vlefshme të konsumatorëve tanë.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike bëhet përmes këmbyesve të energjisë të cilët janë të vendosur në nënstacione dhe bëjnë kalimin e energjisë nga rrjeti primar në rrjetin sekondar. Rrjeti sekondar është pjesë e konsumatorëve dhe rrjedhimisht Ngrohtorja e Qytetit është përgjegjëse për distribuimin e energjisë deri te këmbyesi.




Figura 2. Rrjeti primar i sjellësit të ujit të ngrohtë

Synimet e ndërmarrjes

N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. ka për synim furnizimin e konsumatorëve me ngrohje sa më cilësore, shërbime të efektshme me përkujdesje si dhe arritja deri te finalizimi i projektit. T'u ofrojmë konsumatorëve shërbime të mira dhe të vazhdojmë të mbajmë nivelin e deritashëm të pagesës së faturave, t'u mundësojmë punëtorëve tanë zhvillim personal dhe karrierë të kënaqshme, t'i bindim donatorët që investimet e tyre do të jenë të shpagueshme.

Synimet kryesore për vitin 2022 mund të përmbliken sikurse më poshtë:

1. Trajnimet janë paraparë në kuadër të projektit "Përmirësimi performancës së Ngrohtores së Qytetit në Gjakovë" me fondet e siguruar nga SECO andaj në këtë drejtim priten veprimet duke filluar nga Maji 2022.
2. Sigurimi i të hyrave të përgjithshme nga inkasimi i sezonës dhe borxheve të vjetra në mënyrë të vullnetshme apo me anë të përmbarimit për klientët të cilët nuk u janë përmbajtur marrëveshjeve.
3. Mbajtja e shpenzimeve operative në nivel sa më të ulët që mundëson rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjes prandaj në kuadër të objektivave kryesore për stabilitet financiar të ndërmarrjes nevojitet që të vazhdohet aktiviteti.
4. Në kuadër të kontakteve të vazhdueshme me akterët vendimmarrës, do të kërkohet që për të mbajtur vijimësinë e punës. ME të realizojë zotimet për vazhdimin me subvencione sikurse viteve paraprake, kurse KK Gjakovë të realizojë pagesat.
5. Krijimi i zingjirit furnizues me biomasë ngelet sfida kryesore, andaj nevojitet angazhim dhe koordinim me të gjithë akterët relevant nga niveli lokal dhe qendror.

Menaxhmenti i Kompanisë gjatë vitit 2021, si dhe tërë stafi i kompanisë janë munduar me përkushtimin e tyre maksimal t'i arrijnë caqet e dëshiruara të biznesit dhe konsumatorit t'i ofrojnë shërbimet më të mira. Raporti në mes të ndërmarrjes dhe konsumatorit, si një element thelbësor, ka vazhduar të jetë ndër vlerat më të mëdha të ndërmarrjes, duke përfshirë informimin e vazhdueshëm të tyre për shërbimet, shqyrtimin me kohë dhe në mënyrë efektive të kërkesave të tyre.

Aktivitetet dhe preforma e ndërmarrjes

Në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit 2021. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2021 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera nga aktivitetet kryesore të ndërmarra.

1.5. Sektori i Financave dhe Thesarit

Raportet financiare prezantojnë në mënyrë të përgjithësuar të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Ndërmarrja, sa janë realizuar ato duke i prezantuar përmes tabelave si dhe duke dhënë sqarime me detale.

Gjendja e rënduar financiare, e krijuar nga periudhat e mëhershme, si dhe çmimi gjithnjë e më i lartë i lëndës djegëse ka bërë që ndërmarrja gjatë viteve të fundit të operoj vetëm nga 3 muaj gjatë vitit. Gjatë vitit 2021 ndërmarrja ka operuar disa ditë në janar dhe disa ditë në shkurt gjatë fazës testuese. Ndërsa operimi për sezonin 2021/2022 ka filluar me 21.10.2021 dhe po vazhdon me synimin që të jetë sezon sa më e gjatë.

Çmimi të cilin e paguajnë konsumatorët tanë kundrejt shërbimeve të ofruara nga Ngrohtorja e Qytetit, llogaritet duke u bazuar në tarifat të cilat përcaktohen paraprakisht nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Këto tarifa përcaktohen duke u bazuar në shumë faktorë, duke shfrytëzuar një metodologji të caktuar.

Përcaktimi i tarifave bëhet para çdo sezoni të ngrohjes. Nga viti 2013 nuk kemi pas shqyrtim tarifar, për shkak të gjendjes së rënduar financiare. Me kërkesë të menaxhmentit të Ngrohtores, tarifat e aprovuara në vitin 2013, vetëm janë vazhduar edhe për vitet tjera. Në Qershor është kërkuar nga ZRRE që të bëjmë aplikimin për tarifa të reja. Pas takimeve me Bordin e ZRRE-së dhe kërkesës sonë për të vazhduar me tarifa të njëjta, në Dhjetor 2021 kemi marrë një letër nga ZRRE ku obligohemi të aplikojmë për tarifa të reja për sezonin 2021/2022. Në rast të mos aplikimit, nuk do të na lejohet faturimi prej muajit Janar. Me datën 24.12.2021 bazuar në letrën e marrë nga ZRRE është dorëzuar aplikacioni i përgatitur nga eksperti i angazhuar në kuadër të projektit të ko-gjenerimi

Më poshtë janë të paraqitura tarifat për sezonin ngrohës të vitit 2020/2021:

Tabelë 1. Tarifa për konsumatorët që faturohen sipas sipërfaqes në m²

Komponentët e tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët komercialë e institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenti fikse)	0.09 [€/m ² për muaj]	0.12 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenti variable)	0.88 (€/m ² për muaj)	1.27 (€/m ² për muaj)
TOTALI	0.97 (€/m² për muaj)	1.39 (€/m² për muaj)

Tabelë 2. Tarifa për konsumatorët me matje (njehsor)

Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenti fikse)	0.91 (€/kë për muaj)
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenti variable)	58.76 (€/MWh)

Gjatë fillimit të vitit në Janar dhe Shkurt janë bërë testimet e Ngrohtores së re dhe kemi faturuar vetëm disa ditë, për këtë arsye kemi pasur faturim më të ulët. Pastaj nga tetori kemi startuar me ngrohje dhe ka vazhduar deri në fund të vitit dhe po vazhdon edhe në 2022, ka funksionuar vetëm pjesa jugore ndërsa pjesa veriore ka pasur ndërprerje për shkak të punimeve në rrjet përmes projektit “Përmirësimi i performancës së Ngrohtores së Qytetit në Gjakovë”.

Më poshtë gjeni tabelën:

- Bilancin të Gjendjes për periudhën 01.01.2021-31.12.2021
- Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021
- Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 202

Tabelë 4. Bilanci i Gjendjes

"Ngrohtorja e Qytetit" SH.A.			
Pasqyra e pozitës financiare me 31 Dhjetor 2021			
	Shënimi	2021	2020
		€	€
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	415 200	234 673
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	172 864	117 472
Stoqet	6	192 967	158 418
Instrumentet financiare derivative			
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë			
Pasuritë e klasifikuara si të mbajtura për shitje			
Pasuritë e tjera afatshkurtra	7	152 174	19 950
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		933 205	530 513
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	8	14 159 849	1 176 351
Investimet e mbajtura deri në maturim			
Pasuritë financiare të mbajtura për shitje			

Investimet e trajtuara sipas metodës së ekuitetit			
Prona investuese			
Investimet në vijim			
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		14 159 849	1 176 351
Gjithsej pasuritë		15 093 054	1 706 864
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9	158 216	137 301
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër			
Tatimet e pagueshme aktuale	10		4 688
Të hyrat e shtyra	11	752 973	63 835
Provizionet afatshkurta			
Përfitimet e punonjësive të pagueshme	10		14 036
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër			
Detyrimet e tjera afatshkurtra	11	46 530	2 753
Detyrimet kontigjente			42661
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		957 719	265 274
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë			
Provizionet afatgjata			
Të hyrat e shtyra, pjesa afatgjatë	12	13 538 096	707 252
Detyrimet e shtyra tatimore			
Përfitimet e punonjësive të pagueshme			
Detyrimet e tjera afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata		14 188 881	707 252
Gjithsej detyrimet			
		14 495 816	972 526
EKUITETI			
Kapitali aksionar	13	2 143 322	2 143 322
Fitimet e mbajtura	13	(1 546 083)	(1 408 984)
Rezervat e tjera			
Gjithsej ekuiteti		597 239	734 338
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		15 093 054	1 706 864

Tabelë 5. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021	2020
		€	€
Të hyrat	14	886 316	677 317
Kostoja e shitjes	15	(223 875)	(394 681)
Fitimi / (humbja) bruto		662 441	282 636
Të ardhurat tjera			
Shpenzimet e shpërndarjes	16	(466 047)	(255 932)
Shpenzimet administrative	16	(333 493)	(306 272)
Fitimet/humbjet tjera – neto			-
Fitimi / (humbja) operativ		(137 099)	(279 568)
Shpenzimet financiare		0	0
Të ardhurat financiare		0	0
Fitimi / (humbja) para tatimit	17	(137 099)	(279 568)
Shpenzimet e tatimit në fitim		0	0
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(137 099)	(279 568)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i PF të operacioneve të huaja, neto nga tatimi			
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit			
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		(137 099)	(279 568)

Tabelë 6. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2020	2 143 322	(1 129 416)	-	1 013 907
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	-279 569	-	-279 569
Diferencat nga përkthimet valutore				
Dividendat				
Deponimet e kapitalit shtesë				
Ndarja e rezervave		0	0	
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2 143 322	(1 408 984)		734 338
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(137 099)		(137 099)

Diferencat nga përkthimet valutore				
Dividendat				
Deponimet e kapitalit shtesë				
Ndarja e rezervave				
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2 143 322	(1 546 083)	0	597 239

Tabelë 7. Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021	2020
		€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		(137 099)	(279 568)
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		466 047	141 485
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Amortizimi i pasurive të paprekshme			
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme			
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese			
Të ardhurat financiare			
Shpenzimet financiare			
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve			
Shpenzimet e tatimit në fitim			
		328 948	138 083
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		-55 391	202 396
(Rritja) / zvogëlimi në stoke		-34 548	70595
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		-132 223	65 292
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		20 916	-23 338
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		-17 609	56644
Rritja/Zvogëlimi në të hyrat e shtyra		13 519 983	
Tatimi në fitim i paguar			
Interesi i paguar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		13 630 075	233 505
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			

Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme			
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme			
Interesi i arkëtuar			
Dividendat e arkëtuara			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë			
Dividendat e paguara			
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë			
Ripagimi i kredive dhe huave			
Pagesat e lizingut financiar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		180 530	233 505
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		234 671	1 167
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		415 201	234,672

1.6. Sektori i faturimit dhe inkasimit

Edhe pse kërkesat për ofrim të shërbimit për klientët kanë qenë të mëdha, janë konsideruar vetëm ata të cilët kanë qenë të përshtatshëm në aspektin e afërsisë së rrjetit, duke patur kujdes që këto kyçje të mos dëmtojnë kualitetin e ngrohjes për klientët ekzistues.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për numrin e klientëve të cilët kanë marrë shërbim nga Ngrohtorja e Qytetit duke filluar nga Dhjetor 2020.

Muaji	Numri i klientëve
Janar 2021	419
Tetor 2021	360
Nentor 2021	446
Dhjetor 2021	501



Përkundër pengesave dhe sfidave të cilat i kemi pasur me leje mjedisore dhe licencë nga ZRRE me një javë vonësë kemi filluar sezonin ngrohës për vitin 2021/2022.

Në tabelën e mëposhtme i gjeni shifrat e faturimit për çdo muaj të këtij tremujori të fundit. Në muajin Tetor, Nëntor dhe Dhjetor janë kyçur gjithsej 11 konsumatorë të rinj.

Inkasimet dhe pagesat e marrëveshjeve sipas ligjit për faljen e borxheve

Ligji për faljen e borxheve ka vazhduar edhe gjatë vitit 2020/2021. Shuma e marrëveshjeve të

	Ligji nr. 05/L-043	Ligji nr. 05/L-119	TOTALI
Nr. i konsumatoreve per marreveshje	362.00	95.00	457.00
Borxhi I falur	345,711.34	104,613.66	450,325.00
Shuma e marreveshjes	119,662.00	34,529.54	154,191.54
Borxhi total	465,373.34	139,143.20	604,516.54
Borxhi i mbetur	12,060.28	746.40	12,806.68
Marreveshjet e perfunduara deri me 31.12.2021	327.00	90.00	417.00
Gjithsej shuma e marreveshjeve te perfunduara	107,601.72	26,563.60	134,165.32

Nr. i konsumatoreve me kthim borxhi	38
Gjithsej shuma e kthimit te borxhit	10,764.16

përfunduar gjatë vitit 2021, respektivisht deri me datën 31.12.2021, është 134,165.32 €

Faturimi

Faturimin për vitin 2021 përfshin periudhën prej 22.01.2021-31.12.2021. Gjatë kësaj periudhe është operuar gjatë muajve.

Janar – pjesërisht (prej 22.01.2021)

Shkurt – pjesërisht (deri më 18.02.2021)

Tetor – pjesërisht (prej 21.10.2021)

Nëntor

Dhjetor

Në tabelën në vijim i gjeni të dhënat e faturimit për vitin 2021, të ndara sipas grupimeve të klientëve.

	Sipas grupimit	Shuma
Amvisëria	Banesat	43,281.13
	Shtëpitë	48,968.97
	Kyçjet e reja	2665.00
	Total	94,915.10
Bizneset	Shëndetësia	54193.55
	Shkollat	55878.15
	Institucionet publike, komerciale dhe shtetënores	39499.94
	Lokalet	10011.71
	Kyçjet e reja	0
	Total	159,583.35
	Grand Total	254,498.45

Shpenzimet

Shpenzimet për vitin 2021 po ju paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Lloji i shpenzimit	Shuma
Energjia elektrike	41,384.57
Ujë	16,296.12
Telefon	1,459.09
Tjerat	172,202.17
Total	231,341.95
Shpenzimet e pagave	191,776.29
Grand Total	423,118.24

Në muajin Dhjetor është bërë pagesa e parë prej donacionit me kompaninë kontraktuese Adetex pagesë në emër të kontratës 2 për rehabilitim të nënstacioneve për ngrohje në vlerë prej 100,141.80€. e cila gjithashtu është e përfshirë tek shpenzimet e cekura më lartë, shpenzimet e auditimit (1,490.00€), taksa fillestare për shqyrtim të aplikacionit për vazhdim licencë të aktivitetit të shpërndarjes së energjisë termike – ZRRE (500.00€), gjithashtu takes fillestare për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga BRE- biomasa (1,000.00€) shpenzimet e mbeturinave (693.00 €) , shpenzimet e trajnimit (45,000.00€), shërbimet mjekësore (728.00 €), Leje mjedisore - departamenti për mbrojtjen e mjedisit dhe ujerave MEA (9,605.00 €), lëndët përmbartimore (371,70 €)

1.7. Sektori i prokurimit

Në periudhën Janar – Dhjetor 2021, bazuar në planin e prokurimit të aprovuar në fund të vitit 2021, janë zhvilluar procedurat e prokurimit si në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 10. Aktivitetet e prokurimit

Nr.	Përshkrimi	Data e shpalljes	OE fitues	Vlera e kontratës
1	Rregullimi i gypave	04.03.2021	NTSH"Mitroterm"	610.00
2	Furnizim me gdhendla druri-Biomasë	19.03.2021	Konzorciumi: Muriqi BI,Noli Projekt dhe Feniks-A SHPK	370,997.00

3	Shërbimet e sigurimit fizik	01.07.2021	Kingdom Security	977.90
4	Furnizim me Testomat	17.09.2021	Profitech	988.80
5	Furnizim me tableta kripe NaCl	26.10.2021	Euroni	900.00
6	Auditimi i jashtëm për 2021	29.10.2021	Quatra Audit LLC	1298.00
7	Servisimi i aparateve kundër zjarrit	17.11.2021	Tekniku	971.00
8	Furnizim me material zyrtar	09.12.2021	Nobeli NTSH	984.90
			Total:	377,727.60

DATA	VLERA
14.09.2021	51,795.35 €
05.10.2021	50,481.18 €
04.11.2021	55,737.89 €
10.12.2021	73,725.00 €
21.12.2021	68,260.46 €
TOTALI:	299,999.88 €

Blerja e lëndës së parë

Blerjet e biomasës janë shpenzimi kryesor, por këto blerje janë bërë me mjetet e ndara nga subvencioni për vitin 2021, të cilat ishin në vlerë prej 300,000.00 €. Pranimi i mjeteve të subvencionit është i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Ndërsa fatura të pranuar për blerjen e biomasës për vitin 2021 janë gjithsej 89, në vlerë prej 302,365.94 €. Gjithsejtë vlera e pagesave për vitin 2021 është 299,999.88 €

1.8. Sektori Juridik/Administrativ

Shërbimi i përgjithshëm administrativ-juridik në NP "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë gjatë periudhës 01.01.2020-31.12.2020 ka kryer këto aktivitete:

- Asistimi dhe mbarëvajtja e mbledhjeve të BD-ve.
- Përgatitja e procesverbaleve dhe materialeve të nevojshme për mbledhjet e BD-ve dhe KA-it.

- Konkursët e shpallura
- Kontratat e punës, kontratat për furnizim dhe kyçje
- Bashkëpunimi me përmbauesit privat
- Kërkesat për shpalljen e tenderëve
- Bashkëpunimin me Gjykatën Themelore Gjakovë dhe Prishtinë
- Përgatitja e dokumenteve zyrtare: marrëveshje, kërkesa, njoftime, vendime të ndryshme si dhe punë të tjera për nevojat e ndryshme të ndërmarrjes

Gjatë kësaj periudhe kohore Janar-Dhjetor 2021 shërbimi juridik ka asistuar në 7 mbledhje të BD-ve dhe në 3 mbledhje të Komisionit të Auditimit për vitin 2021.

1.9. Burimet njerëzore

Ndërmarrja ka të punësuar gjithsej 30 punonjës. Përgatitja e punëtorëve sipas kualifikimit të tyre është: Master 13 %, Fakultet 13%, Shkollë të lartë 4% dhe shkollë të mesme 70%.

Tabelë 11. Kualifikimi i punëtorëve

Numri i përgjithshëm i punëtorëve	Meshkuj	Femra	Totali
Magjistër/Master	1	3	4
Fakultet	2	2	4
Shkollë e lartë	0	1	1
Shkollë e mesme	21	0	21
Totali	24	6	30

1.10. Sektori Operativ

Vazhdimi i operimit me teknologjinë e re pa probleme të theksuara, futja në funksion e njësive së ko-gjenerimit në sezonin e ardhshëm si dhe vazhdimi i projektit me SECO-n dhe KK rreth realizimit të komponentëve të saj.

Në kuadër të angazhimeve të gjithmbarshme për vazhdimin e aktivitetit të ndërmarrjes përgjatë vitit 2021 N.P. 'Ngrohtorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë ka parashtruar këto qëllime:

1. Ngritja e kapaciteteve të stafit,
2. Sigurimi i të hyrave të përgjithshme,
3. Sistematizimi i punonjësve në vendet e reja të punës,
4. Bashkërendimi i veprimeve për lëndën djegëse të re (biomasë).




Figure 1. Pamja 3D e objektit të Ngrohtores së Re

N.P. 'Ngrohtorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë kryesisht e ka të kompletuar stafin e administratës dhe udhëheqësit e Shërbimeve që janë të gatshëm për tu përballë me sfidat e ndërrimit të teknologjisë me fillimin e implementimit të projektit të kogjenerimit. Mosha e shtyrë e disa punonjësve të prodhimit duke pas parasysh ndryshimin e teknologjisë, paraqet pengesë në adaptimin e tyre për punë me teknologjinë e re. Andaj duhet të plotësohet me njerëz tjerë të rinj për tu angazhuar në punë me teknologjinë e re. Në kuadër të komponentes Nr.1 të projektit në implementim duhet parë në kuadër të punonjësve aktual edhe mundësitë e sistematizimit.

Përgjithësisht, synimet kryesore për vitin 2021 mund të përmbledhen sikurse më poshtë:

1. Këto qëllime të paraqitura mbështeten në analizat reale të mjedisit të brendshëm të ndërmarrjes. Me fjalë të tjera, meqenëse N.P. 'Ngrohtorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë për shkak të mosfunksionimit të rregullt në sezonin 2020/2021 është gjendur në një pozitë jo shumë të mirë financiare, arritja e këtyre qëllimeve do të ndihmojë në konsolidimin e plotë, ashtu që në Ngrohtoren e re të stabilizohet gjendja financiare duke hapur rrugë për një qëndrueshmëri afatgjatë.

2. Trajnimet janë paraparë nga fondet e siguruara nga SECO andaj në këtë drejtim priten veprimet dhe janë planifikuar për vitin 2022. Po ashtu ka filluar puna me konsulentët rreth përpilimit të rregulloreve të brendshme.
3. Sigurimi i të hyrave të përgjithshme nga inkasimi i sezonës dhe borxheve të vjetra në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara sipas Ligjit për faljen e borxheve si dhe mbajtja e shpenzimeve operative në nivelin e tanishëm që mundëson rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjes prandaj në kuadër të objektivave kryesore për stabilitet financiar të ndërmarrjes nevojitet që të vazhdohet aktiviteti.
4. Në kuadër të kontakteve të vazhdueshme me akterët vendimmarrës, do të kërkohet që për të mbajtur vijimësinë e punës. ME të realizojë zotimet për vazhdimin me subvencione sikurse viteve paraprake kurse KK Gjakovë të realizojë pagesat.
5. Krijimi i zi ngjirit furnizues me biomasë ngelet sfida kryesore andaj nevojitet angazhim dhe koordinim me të gjithë akterët relevant nga niveli lokal dhe qendror.

1.11 Rekomandime

Bordi i Drejtoreve të NP "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova Sh.A. duke pasur parasysh sfidat dhe problemet që ballafaqohet Ndërmarrja për furnizim të lëndës së parë Biomase për të filluar sezonin e ngrohjes së konsumatorëve, rekomando menaxhmentin të ndërmerr masa paraprake për të evituar vonesat eventual në fillimin e sezonës së ngrohjes.

Kryesuesi i BD-ve

Zija Pasha



Anëtar i BD-ve

Xhavit Gashi



Anëtare e BD-ve

Edonjeta Asllani Lata



Anëtar i BD-ve

Dukagjin Morina

